

Shoqata Mjekësore Botrore
Komiteti i Përhershëm i Mjekëve Evropian
Shoqata Mjekësore Gjermane

**Deklarate për Shtyp
10 Nëntor 2015**

Shoqatat mjekësore kritikojnë përpjekjet e qeverisë për të minuar pavarësinë e mjekëve.

Përpjekjet e Qeverisë Shqiptare për të minuar pavarësinë dhe vetë-qeverisjen e mjekëve në vend janë kritikuar ashpër nga Shoqata Mjekësore Botërore, CPME (Komiteti i Përhershëm i Mjekëve të Evropës), dhe Shoqata Mjekësore Gjermane.

Në një letër drejtuar Ministrit të Shëndetësisë të Shqipërisë, udhëheqësit e WMA-së kanë shprehur shqetësimi i tyre në lidhje me përfshirjen e Ministrisë së Shëndetësisë në zgjedhjet për President të Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë duke emëruar kandidatin e tyre. Kur kandidati i tyre humbi zgjedhjet, Qeveria sfidoi rezultatin e zgjedhjeve në gjykatë muajin e kaluar.

Në letrën e tyre, presidenti i WMA- së Sir Michael Marmot dhe kryetari i Këshillit Dr.Ardis Hoven shkruan: "Ne ishim të befasuar kur mësuam përfshirjen e Ministrisë së Shëndetësisë në procesin zgjedhor dhe procedurat ligjore të ndërmarrë kundër Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë. Në mënyrë që UMSH-ja të mbetet e efektshme në përputhje me standardet ndërkombëtare, ajo duhet të ruaj pavarësinë e saj. Kjo është thelbësore për statusin e UMSH-së si një anëtar i rregullt i organizatave ndërkombëtare si: Shoqata Botërore Mjekësore. "

Ata shtuan: "Në emër të Shoqatës Botërore Mjekësore, ne ju sigurojmë juve për mbështetjen dhe angazhimin tonë të vazhdueshëm ndaj kolegëve Shqiptar të profesionit mjekësor dhe i bëjmë thirrje Ministrisë së Shëndetësisë të Shqipërisë për të respektuar pavarësinë e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe të mundësojë sistemin e vetëqeverisjes së mjekëve të lulëzojë në Shqipëri. "

Dr Katrin Fjeldsted, Presidenti i CPME-së, tha: "Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë është një anëtar i vlefshëm i CPME-së. Nëpër Evropë, ne shohim se nga organet përfaqësuese të pavarura dhe demokratike për mjekët përfiton e tërë shoqëria. Ne shpresojmë që autoritetet Shqiptare do të marrin parasysh dhe fuqizimin e Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë ".

Profesor Frank Ulrich Montgomery, President i Shoqatës së Mjekëve Gjermane, gjithashtu i bëri thirrje Qeverisë Shqiptare të njohi rolin thelbësor të luajtur nga Urdhri i pavarur i Mjekëve të Shqipërisë:"Organizatat tona janë të bashkuara në përkushtimin tonë për një sistem të vetëqeverisjes së mjekëve. Për shkak se ajo është provuar për të rritur integritetin profesional dhe për të siguruar cilësinë e kujdesit, efektiviteti i vetë-rregullimit është një nga karakteristikat kryesore të sistemeve shëndetësore në rajonin tonë. "

Në një letër të veçantë për Dr. Fatmir Brahimaj, Presidenti i sapozgjedhur i Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë, udhëheqsit e WMA-së shkruajnë: " Në emër të Shoqatës Botërore Mjekësore, unë ju siguroj juve për mbështetjen dhe angazhimin tonë të vazhdueshëm ndaj kolegëve Shqiptar të profesionit mjekësor. Ne mbështesim plotësisht pavarësinë e Urdhërit të Mjekëve të Shqipërisë dhe i kemi bërë thirrje Ministrisë së Shëndetësisë të Shqipërisë për të respektuar sistemin e vetëqeverisjes së mjekëve në vendin tuaj. Ne ju urojmë forcë dhe vendosmëri për të përballur sfidat e tanishme me të cilat po ndeshet organizata juaj dhe ju bëjmë thirrje për të vazhduar avokimin për çka është më e mira në interes të mjekëve dhe pacientëve të tyre."